



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva Obrazovanja Nauke i
Tehnologije-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV
ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL
FUSHA: TEKSTIL, PËR NIVELIN E PARË (KL.X,XI)

NUMËR: 33/2008
DATË: 19.08.2008

Në bazë të Kapitullit VI, neneve 93 (4) dhe 97 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nenit 6, 8, 11 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i planit dhe programit mësimor për shkollat profesionale, nivelin e parë (kl. X,XI).

Neni 2
Planprogrami

Plani dhe programi i ri për nivelin e parë (kl.X,XI) fusha: *Tekstil, profilet: tjerres, thurres, vektar,konfeksioner*, i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

Neni 3**Zbatueshmëria**

Me zbatimin e planit dhe programit të nivelit të parë zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të klasës X,XI.

Neni 4**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2008/2009.

Enver Hoxhaj, ministër